



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2
Dhjetor 2024

MANAXHIMI I KOMPLIKACIONEVE TE ANESTEZISE LOKALE NE KIRURGJINE ORALE

Esat Bardhoshi*, **Erda Qorri,**** **Orjana Cobani*****, **Merita Bardhoshi******

**Faculty of Dental Medicine , University of Medicine ,Tirana, Albania*

*** Fakulteti i Shkencave shoqërore, Albanian University*

*****Faculty of Dental Medicine , University of Medicine ,Tirana, Albania*

Përmbledhje

Fjala anestezi vjen nga greqishtja “an esthesis” që do të thotë pandjeshmëri , duke theksuar ndryshimin me termin mjekësor analgjezi. Ndjeshmëria është atribut i sistemit nervor në të gjithë komponentet e tij e vecanerisht i sistemit nervor qendror. Ky frenim mund të jetë central ose periferik nëse frenimi është në nivelin e sistemit nervor qendror apo sistemit nervor periferik.

Anestetikët lokalë janë barna të ndryshme të cilet japin një bllokadë të rikthyeshme të përcjelljes së impulsit nervor . Për kryerjen e interventeve të ndryshme në regjionin OMF përdoren disa metoda anestetike: anestezia lokale, sedacioni me ruajtje të koshiences, sedacioni pa ruajtje të koshiencës, anestezi e përgjithshme me maskë , anestezi e përgjithshme me intubim dhe kombinim i sedacionit me anestezinë lokale. Pavarësisht vlerësimit të kujdesshëm të pacientit, preparimit të saktë të indeve dhe teknikave të injektimit, mund të shfaqen komplikacionet sistemike dhe lokale të shkaktuara nga anestezia lokale. Theksi vendoset tek prevenimi, njohja dhe trajtimi i komplikacioneve. Shumica e trajtimeve dentare nuk shoqërohen me diskomfort të dukshëm postoperativ, por me anestezi të zgjatur të indeve të buta pas trajtimit.

Fjalë çelës: *anestezi, pandjeshmëri, bllokadë e rikthyeshme, komplikacione lokale, trajtimi.*

MANAGEMENT OF COMPLICATIONS OF LOCAL ANESTHESIA IN ORAL SURGERY

Abstract

The word anesthesia comes from the Greek “an esthesis” which means insensitivity, emphasizing the difference with the medical term analgesia. Sensitivity is an attribute of the nervous system in all its components and especially of the central nervous system. This inhibition can be central or peripheral

if the inhibition is at the level of the central nervous system or the peripheral nervous system. Local anesthetics are various drugs that provide a reversible blockade of nerve impulse conduction. Several anesthetic methods are used to perform various interventions in the OMF region: local anesthesia, conscious sedation, unconscious sedation, general anesthesia with mask, general anesthesia with intubation, and a combination of sedation with local anesthesia. Despite careful patient assessment, accurate tissue preparation, and injection techniques, systemic and local complications caused by local anesthesia may occur. Emphasis is placed on the prevention, recognition, and treatment of complications. Most dental treatments are not associated with significant postoperative discomfort, but with prolonged anesthesia of the soft tissues after treatment.

Keywords: *anesthesia, insensitivity, reversible blockade, local complications, treatment.*

Hyrje

Aplikimi anestezi lokalë shoqërohet me komplikacione lokale, ne varesi te aplikimit te saj. Keto komplikacione mund te jene :

Parestezia, Në disa raste pacientët ankohen për ndjesinë e mpirjes disa orë ose disa ditë pasi është kryer anestezia lokale. Simptomat mund të jenë të ndryshme: ndjesia e mpirjes, edemës e cila mund të cojnë në disfunkcione orale duke përfshirë humbjen e shijes, vështirësi në të folur dhe kafshimin e gjuhës. Shkaku: trauma ndaj çdo nervi mund të cojë në parestezi.

Kur nervi lingual është dëmtuar, ndjesia e shijes mund të jetë dëmtuar. Shumë parestezi zhduken afërsisht brenda 8 javëve pa trajtim. Në shumicën e rasteve parestezia është minimale dhe risku i dëmtimit të indeve të buta është minimal.

Dëmtimi i zakonshëm është kafshimi i gjuhës dhe buzës se poshtme .

Dëmtimi vaskular

A - Hemoragji: mund të japë vendi i shpimit të gjilpërës që ndalon shpejt

B - Hematomë: ekstravazimi i gjakut dhe grumbullimi në inde. Zakonisht ndodhin gjatë dëmtimit të enëve të pleksusit pterigoid në anestezi dhe n. maksilar/n alveolar superior posterior. Klinika: Fryrje të menjëhershme të faqes në regjionin premaxilar, ngjyrë e kuqe e errët-blutë në lejla-e gjelbër (ndryshon nga shpërberja e gjakut)

Prandalimi: Teknika e kujdeshme, të respektohet thellësia e hyrjes me gjilpërë, ruajtja e kontaktit me kockën.

C - Zona ishemi: në disa zona shfaqet një ishemi i lehtë kalimtare si rezultat i veprimit vazokonstriktor në enët e gjakut. Klinika: zbehje në lëkurë që furnizohet me gjak nga e njëjta vazë që furnizon zonen ku aplikojmë anestezi. Trajtimi: largohet pas 30-40 min. Dëmtimet indirekte intraorale - nekroza

Kryesisht ndodh në palatum. Shkaqet janë: injektimi i shpejtë, sasi e madhe e solucionit anestetik, presioni i madh i injektimit, injektimi i solucionit të gabuar apo të skaduar, prezenca e vazokonstriktorit. Infeksioni Shkaku kryesor i infeksionit pas injeksionit është kontaminimi i gjilpërës para përdorimit të saj. Shkak tjetër është teknika jo e saktë.

Edema është shenjë klinike e pranisë së disa crregullimeve. Shkaqet: trauma gjatë injeksionit, infeksioni, alergji: angioedema është një përgjigje e zakonshme ndaj anestetikëve topikalë esterikë në pacientë alergjikë, hemoragjia injektimi i solucionëve irritues. Shumë raste të edemës së lidhur

me anestetikët lokalë rezultojnë në dhimbje dhe çrregullime të funksionit të regjionit dhe shqetësim të pacientit. Edema angioneurotike e shkaktuar nga anestetikët topikal në individët alergjikë mund të rrezikojë mbylljen e rrugëve të frymëmarrjes.

Materiali dhe metoda

Në këtë studim janë përfshirë 1022 raste klinike 545 meshkuj, 477 femra të trajtuar në shërbimin e kirurgjië orale, KSU për periudhën Prill 2023- Prill 2024 me patologji të ndryshme orale. Për vlerësim e rezultativë të këtij studimi janë përdorur kartelat klinike të pacientëve me të dhënat e mëposhtme : gjeneralitetet e pacientëve, egzaminimi objektiv, ekzaminimi përgjithshëm, diagnoza klinike, anestezia e aplikuar dhe teknika kirurgjikale. Për analizimin e rezultateve është përdorur statistikë descriptive, duke i pasqyruar të dhënat e grumbulluara në tabela dhe grafikë sipas programit Excel.

RASTE KLINIKE



Zonë ishemike

Pacienti mashkull S.G , 27 vjeç. Në disa zona si rezultat i veprimit vazokonstriktor në enët e gjakut, shfaq zbehje në lëkurë që furnizohet nga e njëjta vazë që furnizon zonën ku aplikojmë anestezinë.




Zonë ishemike

Paciente femër A.D, 31 vjeç. Klinika: zbehje në lëkurë pas injektimit të anestezisë lokale në nofullën e sipërme.



Hematomë

Paciente femër F.K , 43 vjeç. Eskravazimi i gjakut dhe grumbullimi në inde .Klinika:ngjyrë e kuqe e errët –blu



Edemë

Paciente femër M.T , 20 vjeç paraqitet me edeme post aplikimit te anestezise lokale.



Parestezi

Paciente femër M.S , femër 26 vjeç.Klinika:Ndjësia e mpirjes pasi është kryer anestezia lokale.



Ulçeracion post anestezië

Pacient mashkull S.T ,56 vjeç.Dëmtim traumatik nga mungesa e ndjeshmërisë pacienti kafshon faqen dhe buzën.

Rezultatet

Tabela nr.1 Gjinia

	n	%
Femër	477	46.7
Mashkull	545	53.3
Totali	1022	100.0

Në studim marrin pjesë 46.7% femra dhe 53.3% meshkuj

Tabela nr.2 Grupmosha

	n	%
deri 25 vjeç	69	6.8
26-45 vjeç	194	19.0
46-65 vjeç	476	46.6
mbi 65 vjeç	283	27.7
Totali	1022	100.0

Referuar grupmohës rezulton deri 25 vjec me 6.7%, 26-45 vjec me 18.9%, 46-65 vjec me 46.7% dhe mbi 65 vjec me 27.7%

Tabela nr.3 Teknika sipas anesteziës

	n	%
Infiltrative	656	64.2
Mandibulare	363	35.5
Mentale	3	0.3
Totali	1022	100.0

Përsa i përket teknikës sipas anesteziës rezulton infiltrative me 64.2%, mandibulare me 35.5% dhe mentale me .3%

Tabela nr.4 Shpërndarja sipas ndërhyrjes kirurgjikale

	N	%
Ekstraksione të thjeshta	700	68.5
Ekstraksione kirurgjikale	150	14.7
Biopsi	12	1.2
Kistektomi	10	1.0
Ndërhyrje në ide te forta	66	6.5
Ndërhyrje në ide te buta	84	8.2
Totali	1022	100.0

Tabela e mësipërme paraqet shpërndarjen sipas ndërhyrje kirurgjikale përkatësisht ekstraksione të thjeshta me 68.5%, ekstraksione kirurgjikale me 14.7%, biopsi me 1.2% , kistektomi me 1%, ndërhyrje në ide të forta me 6.5% dhe ndërhyrje në ide të buta me 8.2%

Tabela nr.5 Shpërndarja sipas komplikacioneve

	n	%
Trismus	6	8.1
Zona iskemike	27	36.5
Parestezi	2	2.7
Hematoma	39	52.7
Totali	74	100.0

Tabela e mësipërme paraqet shpërndarjen sipas komplikacioneve përkatësisht trismus me 8.1%, zona iskemike me 36.5%, parestezi me 2.7% dhe hematoma me 52.7%

Diskutimi

Anestezia lokale është pika kyçe në kontrollin ndaj dhimbjes në stomatologji ,por kërkimet vazhdojnë për gjetjen e mënyrave të përshtatshme të menaxhimit të dhimbjes përpara çdo trajtimi kirurgjikal. Fokusi është në veprimin e medikamenteve të reja që injektohen për të penguar trajktoren e impul-seve të dhimbjes nga zona e trajtimit në SNQ.

Sipas S.Malamed anestezia në nofullën e sipërme rralë mund të jetë problem;me përjashtim të rasteve me anomali anatomike apo rasteve patologjike, në 95% të rasteve arrihet me sukses anestezia. Shumë injeksione mandibulare vërtetojnë që suksezi në bllokun e nervave alveolar inferior është 80-85%.Shkalla e suksesit të anestezimit të nervit alveolar inferior është më e ulët se për shumicën e teknikave të tjera.Anestezimi I nervit alveolar inferior ka shkallë më të ulët suksezi për shkak të dy faktorëve;variacioneve anatomike në lartësinë e foramenit mandibular në anën e linguale të ramusit dhe domosdoshmërinë për penetrim shumë në thellësi të indeve të butë. Në çdo lloj anestezie mund të kemi komplikacione lokale si: nekrozë e indeve të buta,laceracione,hemorragji, hematomë,neurite,-trismus,zona ishemike,infeksion,thyerje e ages,enfizemë subkutane.

Komplikacionet më të shpeshta sipas studimit tonë janë : hematomat, zonat ishemike ,trismusdhe parestezi me një shpërndarje përkatësisht 52.7% , 36.5% , 8.1% ,2.7%.

Sipas J.A Baart & H.S Brand incidenca e dëmtimeve traumatike është 1-3% dhe prevalenca është 20-30%. Pavarësisht vlerësimit të kujdeshshëm të pacientit ,preparimit të saktë të indeve dhe teknikave të injektimit mund të shfaqen komplikacionet sistemike apo lokale të shkaktuara nga anestezia lokale.Komplikacionet lokale më frekvente të anestezisë lokale janë: hemorragjia,trismus,hematoma, edema,parestezi dhe zonat ishemike.

Referencë:

- 1.Bahar E, Yoon H. Lidocaine: A Local Anesthetic, Its Adverse Effects and Management. *Medicina (Kaunas)*. 2021 Jul 30;57(8):782. doi: 10.3390/medicina57080782. PMID: 34440986; PMCID: PMC8399637.
2. St George G, Morgan A, Meechan J, Moles DR, Needleman I, Ng YL, Petrie A. Injectable local anaesthetic agents for dental anaesthesia. *Cochrane Database Syst Rev*. 2018 Jul 10;7(7):CD006487. doi: 10.1002/14651858.CD006487.pub2. PMID: 29990391; PMCID: PMC6513572.
3. Klingberg G, Ridell K, Brogårdh-Roth S, Vall M, Berlin H. Local analgesia in paediatric dentistry: a systematic review of techniques and pharmacologic agents. *Eur Arch Paediatr Dent*. 2017 Oct;18(5):323-329. doi: 10.1007/s40368-017-0302-z. Epub 2017 Sep 14. PMID
4. Becker DE, Reed KL. Local anesthetics: review of pharmacological considerations. *Anesth Prog*. 2012 Summer;59(2):90-101; quiz 102-3. doi: 10.2344/0003-3006-59.2.90. PMID: 22822998; PMCID: PMC3403589.
5. Su N, Liu Y, Yang X, Shi Z, Huang Y. Efficacy and safety of mepivacaine compared with lidocaine in local anaesthesia in dentistry: a meta-analysis of randomised controlled trials. *Int Dent J*. 2014 Apr;64(2):96-107. doi: 10.1111/idj.12087. Epub 2014 Jan 16. PMID: 24428507; PMCID: PMC9376404.
6. Felemban OM, Alshamrani RM, Aljeddawi DH, Bagher SM. Effect of virtual reality distraction on pain and anxiety during infiltration anesthesia : a randomized clinical trial. *BMC Oral Health*. 2021 Jun 25;21(1):321. doi: 10.1186/s12903-021-01678-x. PMID: 34172032; PMCID: PMC8234622.
7. Pipa-Vallejo A, García-Pola-Vallejo MJ. Local anesthetics in dentistry. *Med Oral Patol Oral Cir Bucal*. 2004 Nov-Dec;9(5):440-3; 438-40. English, Spanish. PMID: 15580122.

8. Parekh S, Gardener C, Ashley PF, Walsh T. Intraoperative local anaesthesia for reduction of postoperative pain following general anaesthesia for dental treatment in children and adolescents. *Cochrane Database Syst Rev.* 2014 Dec 23;2014(12):CD009742. doi: 10.1002/14651858.CD009742.pub2. PMID: 25532729; PMCID: PMC6669268.
9. Tirupathi SP, Rajasekhar S. Effect of warming local anesthesia solutions before intraoral administration in dentistry: a systematic review. *J Dent Anesth Pain Med.* 2020 Aug;20(4):187-194. doi: 10.17245/jdapm.2020.20.4.187. Epub 2020 Aug 27. PMID: 32934984; PMCID: PMC7470999.